



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:067457
Datë: 31.07.2024
Numri i dokumentit: 06013655
KPPP.nr.420/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Telekomi i Kosovës” SH.A., me seli në Prishtinë, Lagjja Dardania, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.16/24, të datës 09.02.2024, të Përbaruesi Privat Arsim Bajraktari, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Telekomi i Kosovës” SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.16/24, të datës 09.02.2024, të Përbaruesit Privat Arsim Bajraktari.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr.16/24, i datës 09.02.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Arsim Bajraktari.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.16/24, të datës 09.02.2024, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor - Aktvendimit të Inspektoratit të Punës Nr. 01/08-51/2023 të datës 19.04.2023, me të cilin është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 800.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare,

dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit privat, si dhe regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se kërkesa e kreditorit është në tërësi e pabazuar, urdhri përmbarimor nuk mund të ekzekutohet si dhe nuk është i përmbarueshëm, pasi që nuk i është bashkangjitur dokumenti i besueshëm siç është e përcaktuar me dispozitat ligjore në fuqi. Tutje ka shtuar se rasti i trajtuar nga kreditori ka të bëjë me çështjen e adresuar nga një punonjës kundër këtu debitorit me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, në rastin konkret kreditori në mënyrë të vazhdueshme kundërligjore është duke e shkelur Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës Ko.27/21, sipas të cilit kreditori ka bërë tejkalim të kompetencave të tij. Po ashtu ka theksuar se urdhri përmbarimor është i kundërligjshëm për faktin se në rastet që kanë të bëjnë me kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet e tyre, kompetente për të vendosur në procedurë përmbarimore është gjykata dhe jo përmbaruesi privat, andaj debitori ka kërkuar që procedura në këtë çështje të ndërpritet deri në vendosjen sipas padisë së ushtruar nga ana e debitorit kundër vendimit të kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor, si dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori me përgjigje në prapësim ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, kreditori urdhrin përmbarimor e ka mbështetur në aktvendimin i cili është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, andaj urdhri përmbarimor është i bazuar i argumentuar dhe i ekzekutueshëm. Tutje ka shtuar se vendimet e TEIP janë të ekzekutueshme dhe ushtrimi i padisë në konflikt administrativ nuk e ndal ekzekutimin e vendimit. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përbarimor, përkatësisht Aktvendimin Nr. 01/08-51/2023 të datës 19.04.2023, në bazë të së cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Aktvendimi Nr. 01/08-51/2023 i datës 19.04.2023, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr. 01/08-51/2023 i datës 19.04.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmëris për përbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimit Nr. 01/08-51/2023 i datës 19.04.2023, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 25.07.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 25.07.2023.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka parashtruar padi për hapjen e konfliktit administrativ, dhe janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës përbarimore dhe pritjen e zgjidhjes së çështjes paraprake, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore, ngase në nenin 22 të Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*. Andaj fakti se debitori ka parashtruar padi nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përbarimore.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.420/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.